



REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



02. Nr. 1059/2020

Duke u bazuar në Ligjin mbi Veteqeverisjen Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e kryetarit të Komunës, Ligjin e Financave të Pushtetit Lokal nr. 03/L-049, neni 2, Marrëveshjen e nënshkruar në mes të Komunës së Hanit të Elezit dhe Organizatës Help Hilfe Zur Selbsthilfe E. V / Help me numër të protokollit 02/7306 e datës 28.08.2018 si dhe të Aneks Marrëveshjes së Bashkëpunimit me numër të protokollit 02/9759 e datës 30.10.2019, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për transferimin e mjeteve financiare

1. **LEJOHET** transferimi i mjeteve financiare në shumë prej 3,000.00 € nga buxheti i komunës së Hanit të Elezit nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere në organizatën “Help Hilfe Zur Selbsthilfe E. V / Help” sipas nenit 3 të Aneks marrëveshjes së bashkëpunimit me numër të protokollit 02/9759 e datës 30.10.2019.
2. Komuna e Hanit të Elezit në mbështetje të kësaj aneks marrëveshje do t’i transferoj mjetet si në nenin 1 të këtij vendimi në shumë prej 3,000.00 €, në kuadër të projektit “Programi i trajnimit për vetë-punësim”.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetari i komunës dhe do të ekzekutohet nga drejtoria për buxhet dhe financa.
4. Me këtë vendim njoftohen:
 - OJQ “Help Hilfe Zur Selbsthilfe E. V / Help”
 - Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe
 - Arkivi i Komunës.

Data: 12.02.2020
Hani i Elezit

Kryetari i Komunës
Rufki Suma